

VENDIM
Nr. 633, datë 3.10.2012

**PËR LEJIMIN E SHOQËRISË “KESH” SHA TIRANË, TË IMPORTOJË ENERGJI ELEKTRIKE
PËR FURNIZIMIN E KONSUMATORËVE TARIFORË, SI DHE MBULIMIN E HUMBJEVE NË
SISTEMIN E SHPËRNDARJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shoqërisë “KESH” sh.a., Tiranë, të importojë energji elektrike për periudhën deri më 31.12.2012, për garantimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve me energji elektrike në vend, si dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.

2. Kostot financiare të importit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes sipas pikës 1 të këtij vendimi, t’i faturohen shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., Tiranë.

3. Procedurat e importimit të energjisë elektrike nga ana e shoqërisë “KESH” sh.a. Tiranë, të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

4. Ngarkohet Ministria e Financave për sigurimin e burimeve financiare për kryerjen e importit të energjisë elektrike nga shoqëria “KESH”, sh.a., Tiranë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, si dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për importin e energjisë elektrike të realizuar nga KESH, sh.a.-ja, në periudhat e mëparshme.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe shoqëria “KESH” sh.a. Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha